



Pranimar / Dorezuar Prilijeno / Prilijeno Received / Delivered	27-09-2023	3	viti god year
Organ / Rreza Organ / Jednitca Org / Unit	SKPM/SHUK	6282/2023	114
Pr Prot Pr Prot Prot No			
Shtojca Prilog Appendix			
Sasia Kolicina Quantity			



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1050/23

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.1050/2023, të datës 01.08.2023, të parashtruar nga ankuesja Shqype kundër organit të punësimit: Agjencia për Eficiencë dhe Energji, në çështjen juridike „masë disiplinore“, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 27.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1050/2023, e datës 01.08.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi masa disiplinore “Vërejtje”, e shqiptuar ndaj ankueses përmes Vendimit me numër protokollit 2408, të datës 20.07.2023, të Udhëheqësit të Divizionit për Planifikim në Agjencinë për Eficiencë të Energjisë.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (tutje vetëm ankuesja), më datë 01.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1050/2023, kundër shqiptimit të masës disiplinore “vërejtje” të shqiptuar me datë 20.07.202, nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, me pretendimet ankimore se vërejtja e dhënë është e paqëndrueshme, e pa arsyetuar juridikisht dhe profesionalisht dhe e mbështetur ekskluzivisht në qëndrim personal, gjë që nuk përbënë argument juridik e as ligjor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.06.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 09.06.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje

juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokolli 5036/2023, të datës 08.09.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1050/2023, të datës 01.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 01.08.2023 me numër protokolli 5472/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 2408/2023 të datës 20.07.2023; Vendimin A.nr.809/2023 të datës 12.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses të datës 30.01.2023; Ankesën e datës 02.06.2023 me Nr.Prot:4579/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim të shqiptuar përmes e-mailit zyrtar të datës 05.04.2023; Provat shtesë nga ankuesja të datës 09.06.2023 në Këshill lidhur me vërejtjen e shqiptuar; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.06.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 09.06.2023 nga Ministria e Ekonomisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankueses të datës 31.03.2017 së bashku me formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen të datës 30.01.2023 dhe 31.01.2022; E-mailat zyrtar lidhur me komunikimet e datës 02.02.2022, 31.01.2022, 13.05.2022 ndërmjet ankueses dhe udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë; E-mailin zyrtar lidhur me komunikimet e datës 07.06.2023 ndërmjet udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses dhe udhëheqëses së burimeve njerëzore; Marrëveshjen për punën me vëllim të shtuar me Nr.Prot.755 të datës 01.03.2023; E-mailat zyrtar lidhur me komunikimet e datës 03.05.2023, 04.05.2023, 07.06.2023, 04.10.2023 ndërmjet Udhëheqësit të Divizionit për Planifikim, ankueses, zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë; Letër rekomandimin nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë për ankuesen tek AKEE; Raportet e punës së Komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të subvencionimit të eficiencës së energjisë për qytetarët me Nr.Prot.1440 të datës 02.05.2023, Nr.1666 të datës 19.05.2023, Nr.Prot.1875 të datës 02.06.2023 si dhe Vendimin me numër protokolli VK/2023 të datës 08.09.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesve në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizua shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Me datën 12.07.2023, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur sipas ankesës së ankueses të datës 02.06.2023, me Vendimin me numër A.nr.809/2023, ka shfuqizuar masën disiplinore "Vërejtje" të datës 04.05.2023 e shqiptuar ndaj ankueses nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i saj dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë, me obligimin që Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (tutje AKEE), të bëjë rivlerësimin e shkeljeve të pretenduara disiplinore të ankueses dhe të veproj në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e po të njëjtit vendim.

Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim në AKEE, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses, me datë 20.07.2023, me Vendimin me numër protokolli 2408, ka shqiptuar ndaj ankueses



masën disiplinore "vërejtje", me arsyetimin se kjo masë disiplinore i shqiptohet për shkak të shkeljes së lehtë disiplinore: sjellje të parregullt gjatë kohës së punës me mbikëqyrësin, sipas nenit 43 paragrafit 4 nën paragrafi 4.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se vërejtja në fjalë është e pa qëndrueshme, e paarsyetuar juridikisht dhe profesionalisht dhe e mbështetur ekskluzivisht në qëndrim personal, gjë që nuk përbën argument juridik e as ligjor.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i 'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën e nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45, me të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenit 46, me të cilin është përcaktuar se: "... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta..... 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Nenit 47 paragrafit 1, me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Nenit 48, me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.

Ne kuptim të kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e kundërshtuar me ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Vendimi me numër protokollit 2408, i datës 20.07.2023, për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje", ndaj ankueses nga Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë, bazohet në vërtetim të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të drejtë të dispozitave materiale, ngase sipas provave materiale të kësaj çështje administrative rezulton se me datë 04.05.2023, Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv në AKEE, kishte ftuar në takim ankuesen për të diskutuar lidhur me Projektin për subvencionimin e EE-së, ku për shkak të palëve është ftuar ankuesja që të bisedonin në korridor, mirëpo, e njëjta kishte filluar të bërtas, duke përdorur fjalët "ki kujdes me mua, "; "çfarë ke personale me mua"; "je i nxitur nga të tjerët" etj. Ketë komunikim jo të rregullt të ankueses në raport me Zëvendësuesin e Drejtorit Ekzekutiv në AKEE, e konfirmon edhe vet mbikëqyrësi i ankueses në emalin e datës 04.05.2023 si dhe në vendimin me numër protokollit 2408, të datës 20.07.2023, ku sqaron se komunikimi në korridorin e institucionit është dëgjuar tek zyrat përreth për shkak të tonit të lartë të ankueses, ku dhe vet i kishte dëgjuar akuzat që ankuesja i kishte bërë në drejtim të z. Zeqiri- Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv në AKEE. Andaj, mbi bazën e këtyre

rrethanave, Kolegji i Këshillit konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses ka cilësuar drejtë veprimet e ankueses si shkelje të lehtë disiplinore sipas nenit 46, paragrafit, 4 nën paragrafit 4.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejtë edhe masën disiplinore siç përcaktohet me nenin 50 paragrafin 4 të këtij ligji.

Theksuar si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativë, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1050/2023

Ardita Perçuku-Shyti

[Signature]
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Eficiencë të Energjisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

